



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 211 / Prot.
11

Tiranë, më 26/01 /2024

VENDIM

Nr. 11, datë 26.01.2024

“PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR PROMOVIMIN E PERSONELIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË DHE MIRATIMIN E KRITEREVE QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT PËR ANËTAR NË KËTË KOMISION”

Mbështetur në nenet 3, 37, 38, 46 e vijues të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në nenet 5, 25, 26, 32, 33 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; në nenin 23, pika 6 e Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; në nenin 3 të Rregullores “Mbi organizimin dhe funksionimin e KPPPA-së në UMT-së”, si dhe në Vendimin e Senatit Akademik nr. 20, datë 22.02.2022 “Për krijimin e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik (KPPPA) në UMT”, në mbledhjen datë 26.01.2024, Senati Akademik i UMT-së,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët që do të aplikojnë për të qenë anëtarë të Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik (KPPPA) në UMT, si më poshtë:
 - a) Të jetë personel akademik me kohë të plotë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë;
 - b) Të mbajë titullin akademik “Profesor”;
 - c) Të mos jetë në ndjekje penale dhe ndaj tyre të mos jetë dhënë masë e sigurimit personal;
 - d) Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për vepër penale të kryer me dashje;
 - e) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - f) Të mos ketë shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike” i ndryshuar dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
 - g) Të mos jetë anëtar në më shumë se 2 (dy) komisione të përhershme;
 - h) Të mos jetë anëtar i Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, në njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;

2. Përzgjedhja e anëtarëve të Komisionit të Përhershëm të Promovimit të Personelit Akademik do të kryhet nëpërmjet procesit të votimit të fshehtë nga anëtarët e Senatit Akademik të UMT-së, pas mbylljes së afatit të aplikimeve dhe verifikimit të plotësimit të kriterëve dhe dokumentacionit përkatës të kandidatëve aplikantë.
3. Procedurat e aplikimit, afati dhe dokumentacioni që do të depozitohen kandidatët për anëtar të KPPPA-së, do të përcaktohen me Urdhër të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe në kriteret e përcaktuara në pikën 1 (një) të këtij vendimi.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Drejtoria e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit dhe njësitë kryesore të UMT-së, si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
ARBEN GJATA

